



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



Tirane me 23/12/2018

STATUTI

I

FEDERATES SHQIPTARE TE JUDO-S

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 1


FORMA LIGJORE, PËRBERJA, SELIA

1. Federata Shqiptare e Judo-s, themeluar në vitin 1995 me nr.Vendimi 5056 dt.03/08/1995 (për efekt të këtij Statuti më poshtë do t'i referoheimi FSHJ) është person juridik privat që krijohet në formën e shoqatës. e cila përfaqëson bashkimin vullnetar të shoqatave dhe klubeve sportive të FSHJ në Republikën e Shqipërisë, që vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr,79/2017, datë 27.04.2017 «Për Sportin», Kodit Civil, ligjit nr, 8788, datë 07.05.2001. «Për Organizatat Jofitimprurëse» si dhe ligjit 8789 datë 07.05.2001«Për rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse», si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Federata Shqiptare e Judo-s si anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Judo-s respekton statutin dhe rregulloret, direktivat dhe vendimet e tyre dhe siguron respektimin e tyre nga të gjithë anëtarët e saj.
3. Selia e saj ndodhet në qytetin e Tiranës në adresën **Rr. Grigor Heba, nr. 100**
4. Federata Shqiptare e Judos eshte themeluar me afat te papercaktuar.

NENI 2

FLAMURI STEMA DHE VULA

1. Federata Shqiptare e Judo-s mban stemën të ndërtuar prej lules, që rritet në Shaolin, brënda fushës është vendosur Flamuri Kombëtar ku shkruhet "Federata Shqiptare e Judo_s 1991(ne kete vit jane futur elementet e pare te sportit te Judos dhe jane organizuar aktivitetet e para).
2. Federata Shqiptare e Judo-s ka flamurin e saj të ndërtuar prej fushës së bardhë dhe brënda saj vendoset stema e F.SHJ.
3. Vula është në formë rrethore me ngjashmërinë e Stemës.
4. Asnje anetar ose jo anetar i FSHJ nuk ka te drejte te perdore stemen , flamurin apo vulen e FSHJ pa miratimin zyrtar te Presidentit dhe Sekretarit te Pergjithshem.



Capit



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 3

QËLLIMI DHE FUNKSIONET

Federata Shqiptare Judos është organizatë jofitimprurëse. Të ardhurat që krijohen në FSHJ nga burimet të ndryshme ligjore rriinvestohen për zhvillimin e aktivitetit të FSHJ.

1. Federata Shqiptare e Judos ka këto objektiva dhe detyra:

- Të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë aktivitetin sportiv të shoqatave dhe klubeve të FSHJ, në të gjitha format e tij e në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë statut;
- Të ndihmojë në mënyrë të kualifikuar në rritjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve miqësore midis anëtarëve të federatës si dhe të mbrojtë të drejtat e anëtarëve të saj dhe kujdeset për zgjidhjen e problemeve tekniko-organizative, sportive duke u mbështetur në Statut, Rregullore të saj, legjislacionin shqiptar si dhe aktet ligjore ndërkombëtare të veprimtarisë së sportit përkatës;
- Te organizojë kurse trajnimi dhe te kujdeset për mbarëvajtjen e të gjithë gjyqtarëve të FSHJ, kombëtarë e ndërkombëtarë të aderuar në federatë;
- Të organizojë Kampionatin Kombëtar dhe Kupa e Shqiperise. Dhe te shpalle sportistet kampione, dhe fitues te Kupes se Shqiperise ne pesha dhe kategori te ndryshme. Si dhe ekipin kampion dhe fitues te Kupes se Shqiperise ne qofte se ka organizim ekipor.
- Të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë në federatat ndërkombëtare përkatëse;
- Të organizojë ekipin kombëtar dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive ndërkombëtare ose të autorizojë pjesëmarrjen e anëtarëve të saj në këto veprimtari;
- Të organizojë në Republikën e Shqipërisë veprimtari zyrtare sportive ndërkombëtare dhe të japë leje për organizimin e tyre nga anëtarët e saj, me miratimin paraprak të ministrit përgjegjës.

KREU II

ANËTARËSIA

NENI 4

- Anëtarët e Federatës Shqiptare të Judos të jenë persona juridikë klube sportive, shoqata, shoqëri sportive, të cilat pranojnë aderimin pranë saj duke respektuar statutin dhe rregulloret e funksionimit të FSHJ-së.
- Anëtarët e regjistruar në FSHJ janë të detyruar të kontribuojnë për FSHJ nëpërmjet pagimit të kuotizacioneve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.




Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 5

E DREJTA E FITIMIT TË ANËTARËSISË

1. Personat juridik mund të kërkojnë anëtarësimin në FSHJ vetëm mbasi të jenë regjistruar në regjistrin e institucionit përkatës kompetent në përputhje me rregullat e legjislacionit Shqiptar në fuqi.
2. Komiteti Ekzekutiv i jep shoqatës të drejtën e të qenit anëtar provizor i FSHJ deri në asamblenë e radhës.
3. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi anëtarësinë e një anëtari, por ajo nuk mund ta refuzojë atë përderisa organizimi i kërkuar nuk është në kundërshtim me statutin e Federatës.

NENI 6

TË DREJTAT E ANËTARËVE

Anëtari i Federatës Shqiptare Judos ka të drejtë ;

1. Të pajiset me kartën e anëtarësimi;
2. Të pajiset me statutin dhe rregulloret e Federatës Shqiptare.
3. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme;
4. Të informohet me vendimet e Komitetit Ekzekutiv të Federatës dhe veprimtaritë e Federatës.
5. Të pajiset falas me botimet e ndryshme që bën Federata;
6. Të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare e miqësore, kombëtare dhe ndërkombëtare që organizon FSHJ ;
7. Të njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës.

NENI 7

DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Të jetë korrekt ndaj FSHJ, që nënkupton që çdo anëtar të mos ndërmarrë veprime kundër interesave të FSHJ ;
2. Të paguajë të gjitha detyrimet financiare ndaj FSHJ;
3. T'i komunikojë FSHJ çdo ndryshim në Statut dhe rregulloret e anëtarit si dhe listë të personave ose zyrtarëve me të drejtë firme për të hyrë në marrëveshje ligjore me palët e treta.
4. Të pranojë dhe t'u nënshtrohet Statutit dhe rregulloreve të FSHJ dhe organizmave ndërkombëtare;
5. Për Asamblenë e vet të Përgjithshme të zgjedhë organet drejtuese, ekzekutive dhe në se e gjykon të arsyeshme dhe organin e vet disiplinor;



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



6. Të njohë parimet e ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive;
7. Të njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga këto statute, rregullore, direktiva dhe vendime të FSHJ.
8. Të njohë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) pranë Komitetit Olimpik Shqiptar dhe të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv në Lausanne, Svicër.
9. Pranojnë autoritetin e Organizatës Kombëtar Antidoping, për ushtrimin e veprimtarisë kundër dopingut, për kontrollin e sportistëve dhe dënimin e përdoruesve të dopingut.

NENI 8

PEZULLIMI

1. Shkelja serioze e statuteve, Rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FSHJ i jep të drejtën Asamblesë së Përgjithshme të pezullojë çdo anëtar të saj nga anëtarësimi në FSHJ për një periudhë, e cila parashikohet nga AP
2. Në raste urgjente Komiteti Ekzekutiv mund të japë pezullim provizor deri në Asambleenë e radhës e cila do të shprehet me një vendim, për vendimin e Komitetit Ekzekutiv.
3. Çdo vendim pezullimi përbën humbjen e të drejtave që lidhen me statusin e anëtarit për sa kohë që pezullimi mbetet në fuqi.

NENI 9

HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT

1. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit.
2. Humbja e statusit të anëtarit, nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërmbyshura kundrejt FSHJ ose anëtarëve të tjerë. Pezullimi e përjashton atë nga të gjitha të drejtat që lidhen me FSHJ, veçanërisht nga ato që lidhen me kapitalin e regjistruar në FSHJ.
3. Anetari që nuk paguan detyrimet financiare për dy vite humb statusin e anëtarit. Anetari që nuk merr pjesë në asnjë veprimtari sportive që organizon FSHJ pavarësisht plotësimit të detyrimeve financiare e humbet të drejtën e anëtarit të FSHJ

NENI 10

DORËHEQJA E ANËTARIT

Një anëtar mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje me kusht që ajo të bëhet e vlefshme vetëm në fund të vitit financiar. Kërkesa duhet të paraqitet të paktën 30 ditë më parë.



Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



KREU III

ORGANIZIMI

NENI 11

ORGANET E FEDERATËS SHQIPTARE TË JUDOS

1. Organet e FSHJ-së janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme
 - b) Presidenti
 - c) Komiteti Ekzekutiv.
 - d) Sekretariati i Përgjithshëm (organ administrativ).
2. Komisionet:
 - i. Komisioni teknik.
 - ii. Komisioni i financës.
 - iii. Komisioni i disiplinës.
 - iv. Komisioni i gjyqtarëve.

NENI 12

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Federatës Shqiptare të Judos. Vetëm një Asamble e mbajtur në përputhje me rregullat e këtij statuti, ka autoritetin të marrë vendime.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj të cilët kanë të drejtën e një vote.
3. Mund të marrin pjesë në Asamblesë e Përgjithshme pa të drejtë vote, anëtarët e nderit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
4. Komiteti Ekzekutiv vendos mbi pjesëmarrjen e personave të tjerë në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme.
5. Këta persona nuk kanë të drejtë vote dhe mund të diskutojnë vetëm me leje të drejtuesit të Asamblesë.

NENI 13

KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme e FSHJ ka këto kompetenca:

- a) Miraton ndryshime të statutit të FSHJ në përputhje me ligjin për sportin.
- b) Miraton raportet financiare vjetore të Federatës.
- c) Miraton raportin e komitetit ekzekutiv të FSHJ.
- d) Miraton buxhetin e FSHJ.



Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



- e) Miraton organin e kontrollit financiar të pavarur nga FSHJ sipas ligjeve në fuqi.
- f) Përcakton numrin e plote të antarëve të Asamblesë së Përgjithshme.
- g) Zgjedh presidentin e Federatës.
- h) Zgjedh anëtarët e Komitetit Ekzekutiv .
- i) Miraton propozimet e anëtarëve për dhënie të titujve të nderit brenda juridiksionit të federatës.
- j) Miraton pranimin, pushimin, pezullimin, perjashtimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut
- k) Deklaron shkrirjen e federatës dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare.
- l) Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga K.E.
- m) Miraton rregulloret për zgjedhjet, kodin e etikës, rregulloret e disiplinës.
- n) deklaron shkrirjen e Federatës

NENI 14

EMËRIMI I DELEGATËVE

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të FSHJ janë të detyruar të mbledhin Asamblenë e Përgjithshme të shoqatës, klubit, për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHJ.

1. Anëtarët (klubet, shoqatat) dërgojnë pranë federatës personat zyrtarë të autorizuar për përfaqësimin e tyre.
2. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin zyrtar (autorizim, prokurë) të shoqatës klubit sportiv etj, që vërteton se ai ishte përfaqësues me të drejtë vote.
3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit (pasaportë, karte identiteti)
4. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtari tjetër.
5. Anëtarët (klubet, shoqatat) janë të detyruar që të sjellin emrat e personave të autorizuar për tu përfaqësuar me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme, pranë Sekretariatit të FSHJ jo më vonë se 10 ditë përpara datës së zhvillimit të Asamblesë.

NENI 15

NUMRI DHE PERCAKTIMI I DELEGATEVE


1. Numri i delegatëve përcaktohet si më poshtë :
 - a) Çdo klub sportiv ka 1 (një) delegat .
 - b) Çdo shoqatë sportive ka 1 (një) delegat .
 - c) Çdo shoqeri sportive ka 1 (një) delegat .
2. Çdo delegat ka të drejtën e 1 (një) vote.
3. Anetare me te drejte vote ne Asamblene e Pergjithshme jane vetem individet qe jane perfshire ne listat e federimeve te klubeve, shoqatave apo shoqerive sportive te licensuara prane FSHJ-se
4. Nuk mund të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të FSHJ.
 - a. Persona që kanë qenë përfaqësues me të drejtë vote në një federatë tjetër.
 - b. Klube sportive apo shoqata sportive pa sportistë të licënuar.



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 16

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Komiteti Ekzekutiv jo më pak se një herë në vit. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga KE. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet të dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
3. Çdo anëtar ka të drejtën të propozojë përfshirjen në rendin e ditës të një çështje. Kjo kërkesë duhet të paraqitet në sekretariatit e FSHJ, 7 ditë përpara mbledhjes.

NENI 17

RENDI I DITËS PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË

ZAKONSHME

1. Rendi i ditës për Asamblenë e përgjithshme të zakonshme duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtme:
 - a. Verifikimi i pjesëmarrjes së anëtarëve të mbledhjes.
 - b. Raporti i Presidentit.
 - c. Miratimi i raportit të aktiviteteve të K.E-së.
 - d. Miratimi i raportit financiar.
 - e. Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës.
 - f. Zgjedhjet për çdo vend vakant.
 - g. Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në statutin e FSHJ.
 - h. Diskutime nga anëtarët për çështje të tjera.
 - i. Miratimi i buxhetit
- 2 Rendi i ditës mund të modifikohet nga një mazhorancë që përbën 2/3 e votave të shumicës (50%+1) para fillimit të punimeve të Asamblesë.

NENI 18

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E JASHTËZAKONSHME

1. K.E mund të thërrasë një asamble të përgjithshme të jashtëzakonshme
 2. Kur te pakten 1/3 e anetare te FSHJ bejne kerkese me shkrim per asamble te jashtezakonshme duke percaktuar sakte .
 - a) Kur ka abuzime financiare te vertetuara me dokumenta ose nga auditit i ministrise perkatese.
 - b) Kur ka shkelje serioze te ligjit te Sportit dhe statutit te FSHJ.
- Komiteti Ekzekutiv eshte I detyruar te mbledhe asamblene jo me vone se 30 dite nga data




Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



marrjes njoftimit.

3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 20 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet tu dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. K.E vendos për rendin e ditës kur Asamblenë e thërret ai. Kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 të delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.
6. Rendi i ditës nuk mund të ndryshohet nga çfarëdolloj kushtesh.

NENI 19

VENDIMMARRJA

1. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme kur janë prezent më shumë se gjysma e delegatëve (50%+1) që kanë të drejtë të votojnë, me përjashtim të pikës 2 të këtij neni.
2. Nëse shumica e thjeshtë (50%+1) nuk arrihet, një Asamble tjetër e Përgjithshme duhet të bëhet 24 orë pas të parës, me të njëjtin rend dite. Nuk kërkohet shumicë për mbledhjen e dytë, përveç rasteve kur në rendin e ditës janë parashikuar amendamente në statutin e FSHJ, si zgjedhja e Presidentit dhe e K.E-së, lirimi i një ose disa anëtarëve të një organi të FSHJ, përjashtimi i një anëtar të FSHJ ose shkrirja e FSHJ, për të cilën kërkohet një mazhorancë prej 2/3 e votave të dala nga votimi i delegatëve prezent.
3. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Anëtarët ushtrojnë të drejtën e votimit të tyre përmes delegateve të tyre zyrtarë. Një delegat nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar.
5. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë. Në rast të votave të barabarta, vota e Presidentit është përcaktuese kur votimi është i hapur.
6. Votimi me prokurë nuk lejohet.
7. Vendimet e marra nga Asambleja hyjnë në fuqi një ditë pasi ato janë miratuar, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë më të mëvonshme, ose ia delegon këtë të drejtë K.E-së.

NENI 20

DREJTIMI I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejtohet nga Presidenti ose në mungesë të tij nga një zëvendëspresident. Kur edhe ai mungon mbledhja drejtohet nga anëtar i me i vjetër i K.E-së duke u emëruar Kryetar i ditës.
2. Asambleja cakton komisionin e numërimit të votave të përbërë nga 3 persona.



Qepi



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtarë për diskutim.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili i dërgon ato tek anëtarët brenda 10 ditëve mbas datës së mbledhjes.

KREU IV

NENI 21

ZGJEDHJET

1. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë.
2. Zgjedhjet (me përjashtim të Presidentit) duhet të bëhen mbi bazën e (50%+1) të votave të delegatëve prezent në raundin e parë, dhe pastaj në bazë të një numri më të madh të votave në raundin e dytë. Në rast se votat janë të njëjta bëhet një raund tjetër për të ndarë kandidatët, i cili përsëritet jo më shumë se tre herë. Në rast se përsëri ky votim është i njëjtë, kandidatët duhet të përcaktohen nga shorti, i cili organizohet nga komisioni i numërimit të votave.
3. Zgjedhja e Presidentit të FSHJ ka nevojë për 2/3 e votave të delegatëve prezent në mbledhje. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrijnë 2/3 atëherë dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madhe në raundin e parë kualifikohen për raundin tjetër. Në raundin tjetër, kandidati me numrin më të madh të votave zgjidhet. Në rast se numri i votave në raundin e dytë është i barabartë atëherë zbatohen rregullat e përcaktuara në pikën 2.
4. Ç'do kandidat duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i FSHJ, jo më vonë se 20 ditë para datës së asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është vendosur zgjedhja e K.E-së. Secili kandidat duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme.

NENI 22

PRESIDENTI

1. Kandidati për President duhet:

- të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri,
- të ketë arsim të lartë.
- të ketë figurë të pastër morale.
- të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj.
- të mos ketë konflikt interesash me postin e presidentit:
- të ketë kontribuar mundësisht në fushën e sportit si sportist, trajner, gjyqtar, gazetar apo donator (financues).



Geop...



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 23

DETYRAT E PRESIDENTIT

I. Detyrat e Presidentit janë si më poshtë:

- Të përfaqësojë FSHJ si i vetmi përfaqësues i saj;
- Të kërkojë thirrjen e A.P dhe të thërrasë mbledhjet e K.E-së
- Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe takimet e K.E-së
- Të sigurojë zbatimin e vendimeve të AP dhe të K.E-së
- Në rast se Presidenti mungon, detyrat mund t'i ngarkohen Zëvendës-presidentit.
- Në rastin kur Presidenti jep dorëheqjen K.E cakton zëvendës-presidentin të kryejë funksionet e Presidentit përkohësisht, deri në thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme:

NENI 24

KOMITETI EKZEKUTIV

1. Komiteti Ekzekutiv, është organi më i lartë ekzekutiv i cili përbëhet nga një numër prej 5 vetë (përfshirë presidentin, zëvendës-presidentin dhe anëtarët e tjerë) me një raport të drejtë të përfaqësimit të femrave.

a. Kandidati për anëtar i Komitetit Ekzekutiv duhet:

- Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri,
 - Të ketë arsim të lartë,
 - Të ketë figurë të pastër morale,
 - Të mos jetë i dënuar nga organet drejtësisë shqiptare dhe të huaj.
 - Të mos jetë njëkohësisht trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi.
 - Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni, kolegjiunietj)
 - Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
 - Të jetë i propozuar nga një anëtar i federatës (klub sportiv apo shoqatë anëtare)
 - Të mos ketë konflikt interesash me të qenit anëtar i K.E.
 - Të ketë ushtruar sportin në disiplinën që mbulon federata dhe të ketë fituar gjatë karrierës së tij si sportist apo trajner, të paktën një titull kampioni kombëtar, fitues i një kupe të nivelit kombëtar ose tituj akademikë në fushën e sportit e sportit, apo fitues i nivelit të lartë
2. Anëtarët që e propozojnë kandidatin nuk duhet të jenë të pezulluar.
3. Emrat e kandidatëve, bashkë me kurikulumin e tyre duhet të dërgohen nga anëtarët në Sekretariatit e Përgjithshëm të FSHJ. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ai paraqet rezultatet K.E-së për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet delegatëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari KE duhet të ringrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave sipas kriterëve të përcaktuara në këtë statut.
4. Një anëtar i FSHJ nuk mund të propozojë më shumë se një kandidat për anëtar në K.E.



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 25

KOHËZGJATJA E MANDATEVE

1. Mandati i presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe anëtareve të tjerë të Komitetit Ekzekutiv është 4 vjeçarë . Ata kanë të drejtë të rikandidojnë pa kufizim mandatesh.
2. Komiteti ekzekutiv plotëson vendin e mbetur vakant të anëtarit të tij nga radha e listës së Komitetit Ekzekutiv , në zgjedhjet e fundit të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 26

MBLEDHJET E KOMITETIT EKZEKUTIV

1. K.E mbledhet jo më pak se gjashtë herë në vit.
2. Mbledhja drejtohet nga Presidenti.
3. Presidenti bën njoftimin për mbledhje 5 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. 1/3 e anëtarëve të K.E-së i kërkojnë Presidentit mbledhjen e K.E-së jashtë rradhe. Presidenti duhet të mbajë mbledhjen brenda 3 (tre) javëve pas marrjes së kërkesës .
4. Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë pjesë në takimet e K.E-së pa të drejtë vote.
5. Mbledhjet e K.E-së nuk mbahen në publik. K.E mund të ftojë palë të treta të marrin pjesë. Këto palë të treta nuk kanë të drejtë votimi dhe mund të shprehin opinionin e tyre vetëm me miratimin e Presidentit të FSHJ.
6. Për mbledhjet e K.E. mbahet proces-verbal, i cili firmoset nga Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm dhe nga çdo antar i KE pjesëmarrës në mbledhje dhe vendimet duhet të zbardhen brenda pesë (5) ditëve dhe të bëhen publike.
7. Procesverbalit i mbledhjes ruhet në arkiv në dy kopje. Për dëmtimin, falsifikimin apo humbjen e proces-verbalit, përgjegjësit mbajnë përgjegjësi ligjore.
8. Në rast të mbledhjeve urgjente Komiteti Ekzekutiv mund të shprehet në mënyrë elektronike (email) në formën e një vendimi qarkullues. Zbardhja e vendimit në mbledhjen e ardhshme.
9. Në rast se një anëtar i K.E . mungon tre herë rrjesht pa njoftim dhe justifikim vendi shpallet vakant dhe zëvendësohet.

NENI 27

KOMPETENCAT E KOMITETIT EKZEKUTIV

K.E ka këto kompetenca:

- a. Të menaxhojë dhe drejtojë punët e FSHJ.
- b. Të planifikojë aktivitetet dhe kalendarin e veprimtarive kombëtare dhe ndërkombëtare
- c. Të monitorojë administrimin e FSHJ.
- d. Të zgjedhë zëvendës-presidentin
- e. Të përgatisë dhe të mbajë Asamblesë të Zakonshme të Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme:



Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



- f. Të hartojë dhe miratoj projektbuxhetin dhe ta paraqes në Asamblenë e përgjithshme.
- g. Të emërojë dhe kur e sheh të arsyeshme të shkarkojë kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të përhershme.
- h. Të hartojë rregulloret dhe t'i paraqesë ato për miratim në asamble.
- i. Të përcaktojë, organizojë dhe anullojë aktivitete zyrtare të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar
- j. Të mbajë lidhje me organizatat sportive ndërkombëtare dhe gjithashtu të ushtrojë të drejtën për të propozuar përfaqësues të FSHJ për t'u zgjedhur në këto organizata.

NENI 28

VEPRIMTARIA E KOMITETIT EKZEKUTIV

1. K.E fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. K.E merr vendime me 50%+1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta. Presidenti ka votë vendimtare kur votimi është i hapur.
3. Në rast se një anëtar i K.E-së ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje
4. Vendimet e marra regjistrohen në procesverbal
5. Vendimet e marra nga K.E. hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur KE vendos ndryshe.

KREU VI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NENI 29


1. Sekretariati i Përgjithshëm është organ administrativ i FSHJ dhe drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Struktura e sekretariatit të Përgjithshëm hartohet nga KE dhe miratohet nga Asambleja.
 2. Ministri përgjegjës për Sportet miraton kandidaturen për Sekretar të Përgjithshëm të propozuar nga K.E dhe Presidenti i FSHJ-së, i cili është përgjegjës për veprimtarinë ekonomike financiare të FSHJ (nqs ploteson kriteret në ligj dhe statut).
 3. Sekretari i Përgjithshëm mund të pezullohet nga KE për shkelje të rënda statutore apo abuzime financiare.
- a. Kandidati për Sekretar i Përgjithshëm duhet:
- Të jetë shtetas shqiptar. me banim në Shqipëri.
 - Të ketë arsim të lartë, mundësisht jurist ose ekonomist, apo kualifikime të vërtetuara pasuniversitare për menaxhim.
 - Të ketë figure të pastër morale,
 - Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaj.



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



- Të mos jetë njëkohësisht trajner, gjyqtar, vëzhgues, sekretar klubi apo anëtar i një organi gjykues të F.SHJ.
- Të mos jetë njëkohësisht anëtar i një federate tjetër (anëtar komisioni,
- Të mos jetë i dënuar nga një federatë sportive për thyerje disipline, përdorim dopingu apo për abuzime financiare.
- Të mos ketë konflikt interesash me të qenit Sekretar i Përgjithshëm.


4. Funksionet e tij janë:

- a. Të zbatojë vendimet e Komitetit Ekzekutiv.
- b. Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme dhe për mbledhjet e organeve të tjera dhe komisioneve.
- c. Të programojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të takimeve të K.E-së.
- d. Të mbajë korrespondencën e FSHJ.
- e. Të mbajë librat e llogarisë së FSHJ.
5. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sekretariatit të përgjithshëm dhe për menaxhimin e stafit që punon brenda tij.
6. Ai është përgjegjës për zbatimin dhe koordinimin e veprimtarisë ekonomike financiare të FSHJ.
7. Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, takimet e K.E-së dhe në atë të komiteteve këshilluese në një rol këshillues. Nëse ai nuk është në gjendje të marrë pjesë, duhet të caktojë një përfaqësues të sekretariatit.
8. Të informojë strukturat përkatëse shtetërore për mirëmenaxhimin e grantit, financimeve apo lehtësimeve fiskale që bën shteti për Federatën.

NENI 30

PERJASHTIMI I NJE PERSONI TE ZGJEDHUR

1. K.E mund të pezullojë një anëtar të K.E-së për shkelje statutoare, abuzime financiare të faktuara nga organi kompetent apo për ndonjë shkelje apo veprim tjetër që K.E e çmon si ngjarje të rëndësishme.
2. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin që ta përjashtojë një anëtar kur propozimi për përjashtim votohet me 2/3 e anëtarëve të plotë që përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të federatës.
3. Kur 1/3 e anëtarëve që përbën Asamblenë e Përgjithshme kërkon përjashtimin e presidentit për një arsye të paraqitur në mocionin e mosbesimit. Asambleja e Përgjithshme ka autoritetin për të marrë vendimin ose jo të përjashtimit, kur ky propozim votohet me 2/3 e anëtarëve të numrit të përgjithshëm që përbëjnë asamblenë.



Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



K R E U VII

FINANCA

NENI 31

PERIUDHA FINANCIARE

I. Periudha financiare do të jetë viti kalendarik.

NENI 32

BURIMET FINANCIARE


I. Të ardhurat e Federatës Shqiptare sigurohen nga:

- Granti i përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për sportin.
- Regjistrimet vjetore të anëtarëve
- Të ardhurat e krijuara nga marketingu i të drejtave që gëzon Federata Shqiptare:
- Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara (te gjitha veprimet behen nepermjet bankave).
- Nga licënsimi trajnerëve, sportistëve, gjyqtarëve, mjekëve, vëzhguesve, specialistëve, amatorëve, menaxhereve etj;
- Te gjitha tarifat per licënsimet te sportistëve ,instruktorve , trajnerëve ,gjyqtarëve , klubeve shoqatave , personat qe testohen per Graden DAN dhe License miratohen ne Asamblene e Pergjithshme me propozim te Komitetit Ekzekutiv.

NENI 33

KONTROLLI MJEKESOR NE SPORT

- Asnjë sportist nuk mund të anëtarësohet në FSHJ dhe të marrë pjesë në veprimtaritë sportive të organizuara prej saj, pa paraqitur vërtetimin mjekësor që e lejon atë të ushtrojë sportin që ka zgjedhur. Sportistët e judos të anëtarësuar në FSHJ pajisen me kartelë mjekësore vetjake.
- Kontrolli mjekësor i sportistëve bëhet nga mjekë të licensuar, të paktën një herë në vit, për matjen e parametrave jetësorë.
- Kontrolli mjekësor për të gjitha kategoritë e ekipeve kombëtare të judos bëhet nga struktura përgjegjëse e kontrollit mjekësor dhe rehabilitimit pranë Qendrës së Shërbimit të Sportit dhe Përgatitjes së Ekipeve Kombëtare.
- Organizuesit e veprimtarisë sportive mbajnë përgjegjësi administrative për aktivizimin e sportistëve pa kartelë mjekësore në garat sportive.



Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



ENI 34

SIGURIMI SHËNDETËSOR I SPORTISTEVE

1. Organizatat sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHJ-se, janë përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve që marrin pjesë në veprimtaritë sportive të FSHJ-se.
2. Sigurimi shëndetësor i sportistëve përballon të gjitha shpenzimet për mjekimin e dëmtimeve që mund t'u ndodhin sportistëve gjatë veprimtarisë së tyre sportive.
3. Organizata sportive (klube sportive, shoqëri sportive, shoqata sportive) anëtare të FSHJ-se, që lejojnë pjesëmarrjen në veprimtaritë sportive e sportistëve të FSHJ-se të pasiguruar nga ana shëndetësore, detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për rehabilitimin e sportistit në rast dëmtimi në veprimtarinë sportive, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

FSHJ-ja është përgjegjëse për sigurimin shëndetësor të sportistëve të ekipeve kombëtare gjatë grumbullimeve stërvitore dhe pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare të judos.

ENI 35

SPORTISTI

1. Sportisti ka të drejtë ta zgjedhë vetë shoqatën sportive, shoqërinë sportive, klubin sportiv ku dëshiron të anëtarësohet dhe ta ndryshojë atë në përputhje me statutet e tyre dhe rregulloret e përcaktuara nga FSHJ-ja.
2. Pjesëmarrja e sportistit në këto organizata bëhet sipas procedurave të përcaktuara në statut dhe në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës. Sportisti është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës.
3. Transferimi i sportistit të judos nga një klub sportiv në një tjetër, brenda ose jashtë vendit, bëhet në përputhje me rregulloret e veprimtarive sportive të miratuara nga FSHJ-ja dhe nga Federata Ndërkombëtare e Judos.




Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albiudofederation@hotmail.com



NENI 36

KATEGORITE E SPORTISTEVE

1. Sportistët ndahen në amatorë dhe profesionistë, sipas kushteve të përcaktuara në këtë statut dhe në rregulloret e FSHJ-se.
2. Sportistë amatorë të judos janë ata sportistë, që praktikojnë sportin e judos dhe nuk kanë ndonjë kontratë pune të lidhur me klubin sportiv apo shoqatën sportive ku janë regjistruar.
3. Sportistët profesionistë të judos janë ata persona që praktikojnë sportin e judos si një profesion dhe fitojnë të ardhura në bazë të nënshkrimit të kontratës së punës me shoqatat, shoqëritë apo klubet sportive në të cilat ata janë anëtarë.

NENI 37

STATUSI I SPORTISTIT TE NIVELIT TE LARTE

Sportistët e judos të cilët përfitojnë statusin e nivelit të lartë në përputhje me Ligjin për Sportin, klasifikohen sipas rezultateve të larta sportive në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: "rekord olimpike", "rekord botëror", "rekord europian", "vendi i parë deri në të tetin në Lojërat Olimpike", "vendi i parë deri në të gjashtin në kampionate botërore" dhe "vendi i parë deri në të tretin në kampionate europiane" dhe "vendi i parë në Lojërat Mesdhetare". Në veprimtari kombëtare zyrtare: "sportisti i cili thyen rekordin kombëtar" dhe "vendi i parë në kampionatin kombëtar".

NENI 38

TRAJNERI

1. Klubet sportive, shoqatat dhe shoqëritë sportive anëtare të FSHJ duhet të punësojnë trajnerë të licencuar nga FSHJ-ja dhe të nënshkruajnë kontratë punësimi, në përputhje me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
2. Klubet sportive, shoqatat, shoqëritë sportive dhe FSHJ-ja, kanë përgjegjësi për kualifikimin dhe trajnimin e mëtejshëm të trajnerëve në bashkëpunim me institucione përkatëse të fushës.



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 39

DETYRIMET E SPORTISTIT DHE TRAJNERIT

1. Sportisti i judos duhet të respektojë rregullat e FSHJ-se. dhe të Federatës Ndërkombëtare të Judos, parimet etike të sportit dhe të *fair-play*-t, kushtet e Konventës Ndërkombëtare të Antidopingut dhe rregulloret e veprimtarisë së judos.
2. Trajnerët respektojnë rregullat e *fair-play*-t, parimet e Kodit të Etikës, Konventën Ndërkombëtare të Antidopingut, si dhe rregulloret e FSHJ-se.

NENI 40

DISPOZITA TE VECANTA

Federata Shqiptare e Judos i organizon aktivitetet sportive Kombetare sipas rregullores teknike te Federates Boterore te Judos(IJF) per meshkuj dhe femra per kategorie Senior ,Te rritur , Junior , Cadet , Femije sipas peshave te miratuara nga IJF duke respektuar rregulloren teknike

- a) Federata Shqiptare e Judos organizon kurse trajnimi per :
 - Instruktorë Niveli Pare
 - Trajnere niveli Dytë
 - Mjeshter Pro License neveli Tretë

Sipas programeve te akademise se Judos prane IJF.


- b) Organizon kurse trajnimi dhe testime per pajisje me Graden DAN te sportisteve , trajnereve dhe specialisteve te Judos.
- c) FSHJ mbështetur ne kurset e trajnimeve ,kualifikimeve Grades DAN ,karrieres sportive pajis me license per ushtrimin e profesionit (instruktor ,trajner , mjeshter) te pjesmarresve ne keto kurse duke respektuar standartet e aplikimit dhe testimit sipas programeve te IJF
- d) FSHJ kerkon te zbatohet Kodi i etikës sipas standarteve te IJF .Ky Kod eshte I vlefshem per te gjitha veprimtarite sportive brenda dhe jashte vendit,
- e) Per percaktimin e sportisteve elitar merret parasysh Ranking Lista e IJF ,EJU , Aktiviteteve Ballkanike ,dhe rezultatet ne aktivitetet Kombetare si dhe vendimet e Keshillit te Ministrave te cilet percaktojne kriteret kush mund te jete pjesmarres
- f) FSHJ zbaton te gjitha rregullat e Kodit te antidopingut .



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 41

SHQYRTIMI ADMINISTRATIV

1. FSHJ krijon organet e gjykimit disiplinor, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloret e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Organet e gjykimit disiplinor të FSHJ-se shqyrtojnë dhe vendosin masa ndëshkuese ndaj pjesë-marrësve në veprimtaritë, garat sportive, që kryejnë shkelje disiplinore ose teknike, në kundërshtim me rregulloren e veprimtarisë dhe/ose me rregulloren e disiplinës së FSHJ-së.
3. Sanksionet disiplinore miratohen në rregulloret përkatëse të disiplinës.
4. Vendimet e organeve të gjykimit disiplinor të FSHJ-se, mund të ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 15-ditëve kalendarike nga shpallja e tyre.

NENI 42

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Vendimet e organeve të FSHJ nuk mund të jenë objekt ankimi dhe gjykimi në gjykatën civile. Kunder ketyre vendimeve mund të apelohej në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv, pranë KOKSH dhe me të drejtë ankimi në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv CAS Lausanne, vendim i të cilit është i formës së prere.

FSHJ-ja pranon autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv.

1. Vendimet e organeve drejtuese të FSHJ që bien në kundërshtim me ligjin dhe me këtë Statut, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit të judos, ankimohen në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (KAS), organ i ngritur pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Të gjitha organizatat sportive të judos kanë të drejtën e ankimit për vendimet e organeve drejtuese dhe mosmarrëveshjet.
2. Vendimet e paneleve të arbitrave/ndërmjetësve ankimohen pranë Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) brenda 30-ditëve nga data e shpalljes së vendimit. Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) shqyrton ankimin brenda 30-ditëve dhe merr vendim.
3. Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, FSHJ-ja, klubet dhe shoqatat sportive, shoqëritë pranojnë autoritetin e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS). FSHJ-ja njih dhe zbaton vendimet që merr këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) për vete dhe për anëtarët e saj.
4. Vendimet e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) ankimohen vetëm në Gjykatën e Arbitrazhit të Sportit (CAS), në Lozanë të Zvicrës.


Vendimet e organeve vendimarrëse të FSHJ-se janë të formës së prere. Vetëm në rastet kur ato bien në kundërshtim me ligjet shqiptare në fuqi, statutin dhe rregulloren e FSHJ-se se judos ankimohen. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve për problemet teknike dhe disiplinore bëhet brenda strukturave të Federatës të parashikuara në rregulloren e FSHJ-se. Për mosmarrëveshjet ligjore ankimi dhe zgjidhja tyre bëhet sipas rastit në KAS ose në gjykatën e shkallës së parë të rrethit Tiranë.



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



NENI 43

PËRDORIMIN I SUBSTANCAVE DHE METODAVE DOPING

1. FShJ-ja pranonë autoritetin e Organizatës Kombëtare Antidoping për kontrollin e sportistëve, anëtarë të tyre, dhe dënimin e përdoruesve të dopingut
2. Në procesin stërvitor dhe në veprimtaritë sportive të sportit të Judos është i ndaluar përdorimi i substancave dhe metodave doping.
3. Lista e substancave dhe metodave doping të ndaluara në Republikën e Shqipërisë është e njëjtë me ato të miratuara nga Agjencia Botërore e Antidopingut.
4. Përdorimi i substancave dhe metodave doping, si dhe nxitja për përdorimin e tyre dënohen sipas normave ndërkombëtare, të pranuar nga FShJ

KREU VIII

PARANDALIMI I DHUNËS NË SPORT

Neni 44

Ndalimi i provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara

1. Gjatë veprimtarive sportive të Judos të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohet provokimi ose përpjekja për provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor, që synon nxitjen e urrejtjes e të dhunës ndaj pjesëmarrësve në veprimtarinë sportive dhe/ose ndaj spektatorëve.
2. Gjatë veprimtarive sportive të Judos të të gjitha niveleve ose gjatë transmetimit të tyre në publik ose në mjedise ku ato zhvillohen, ndalohen sjelljet e palejuara të mëposhtme:
 - a. sulmi fizik ndaj çdo pjesëmarrësi në ngjarjen sportive, qofshin pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të veprimtarive sportive apo shikues, ose përleshja fizike mes pjesëmarrësve dhe tifozëve;
 - b. gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës ose në tribunat e tifozëve;
 - c. shfaqja e materialeve propaganduese, me të cilat fyhen ndjenjat kombëtare ose ndjenjat e tjera ose kryejnë provokim me karakter politik, shoqëror, racial, fetar a gjinor;



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com




- d. ndërmarrja e veprimeve që nxisin urrejtje e që mund të sjellin deri në dhunë apo sulme fizike;
 - e. dëmtimi i mjediseve të sportit, pajisjeve sportive, instalimeve dhe pajisjeve të tjera në mjedisin sportiv;
 - f. veprimet me të cilat pengohet hyrja apo dalja e pjesëmarrësve në mjedisin sportiv, pengimi i zhvillimit të veprimtarisë sportive apo shkaktimi i pasigurisë në mjedisin sportiv për pjesëmarrësit apo personat e tjerë;
 - g. hyrja e paautorizuar në hapësirat e mjedisit sportiv dhe të terrenit sportiv;
 - h. hyrja e paautorizuar në hapësirat zyrtare dhe në kalimet zyrtare të mjedisit sportiv ose në pjesën e tribunës që i caktohet tifozëve të ekipit mik;
 - i. djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj., ose e sendeve të tjera në mjedisin sportiv;
 - j. përdorimi i maskave ose sendeve të tjera, me qëllim fshehjen e identitetit ose fshehjen e fytyrës;
 - k. trukimi i rezultateve të veprimtarive sportive.
3. Organizatori i veprimtarisë sportive të Judos është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e veprimtarisë sportive dhe, në veçanti, të kujdeset për marrjen e masave parandaluese të shfaqjes së provokimeve e të sjelljeve të tjera të palejuara.
4. FSHJ, në veprimtarinë kundër dhunës në Shqipëri, respektojnë dispozitat e Konventës Europiane Kundër Dhunës në Sport ku aderon Republika e Shqipërisë.

Neni 45

Sendet e palejuara në objektet dhe mjediset sportive

1. Ndalohen mbajtja dhe përdorimi në objektet e mjediset sportive të Judos dhe gjatë zhvillimit të veprimtarive i fishekzjarrëve, flakadanëve, lëndëve piroteknike dhe sendeve të tjera të forta, të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve, i armëve të të gjitha llojeve, si edhe përdorimi e tregtimi i pijeve alkoolike.
2. Gjatë veprimtarive sportive të Judos personat në cilësinë e përfaqësuesit të FSHJ, gjyqtarëve dhe vëzhguesve, janë të paprekshëm.





Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



Neni 46


Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike

1. Organizatori i një veprimtarie sportive në Judo është i detyruar të njoftojë Policinë e Shtetit me shkrim të paktën 7-ditë kalendarike përpara zhvillimit të saj, me qëllim planifikimin e të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për mbarëvajtjen e saj.
2. Në këtë njoftim, organizatorët duhet të përcaktojnë edhe shërbimin privat të sigurisë fizike (SHPSF) të kontraktuar për marrjen e masave të sigurisë në mjediset sportive të Judos
3. Ruajtja e rendit dhe e sigurisë publike në mjediset sportive është detyrë institucionale e organeve të Policisë së Shtetit.
4. Administratorët e objekteve dhe mjediseve sportive, në bashkëpunim me klubet sportivetë Judos, nëpërmjet shoqërive private të sigurisë fizike (SHPSF), duhet të marrin këto masa:
 - a. të kryejnë kontrollin rigoroz të tifozëve në portat e hyrjeve në mjedisin sportiv;
 - b. të kryejnë sigurimin e vendkalimeve publike në mjedisin sportiv;
 - c. të kryejnë drejtimin e spektatorëve tek ulëset në mjedisin sportiv dhe mbajtjen e tyre nën kontroll;
 - d. të kryejnë sigurimin dhe mbrojtjen e lojtarëve nga futja e tifozëve në mjedisin sportiv.
3. Administratorët e mjediseve sportive marrin masat për caktimin e një ambienti të përshtatshëm për drejtuesit e njësisë policore për monitorimin e situatës së rendit publik në mjedisin sportiv.

Neni 47

Roli i oficerit të sigurisë në veprimtaritë ndërkombëtare

1. Në veprimtaritë ndërkombëtare të Judos brenda dhe jashtë vendit, FShJ merr masa për sigurinë e ekipeve kombëtare nëpërmjet kontaktimit të oficerit të sigurisë.
2. Oficeri i sigurisë duhet:
 - a. Të ketë qenë në nivelin drejtues në Policinë e Shtetit;
 - b. Të ketë përvojë në organizimin dhe menaxhimin e masave të sigurisë gjatë veprimtarive sportive;
 - c. Të ketë gatishmërinë për të punuar me autoritetet publike dhe të Policisë së Shtetit.




Signature



Federata Shqiptare e Judos

Albanian Judo Federation

albjudofederation@hotmail.com



3. Oficeri i sigurisë mban kontakte me autoritetet policore, shërbimet e urgjencës dhe përfaqësuesit e tifozëve. Ai është përgjegjës për vlerësimin dhe raportimin tek organizatori i veprimtarisë sportive, duke marrë masat që ato të mos ndikojnë në sigurinë e veprimtarisë.
4. Oficeri i sigurisë është përgjegjës për vlerësimin e adresimin e rreziqeve dhe për marrjen e masave në koordinim me policinë, shërbimet e emergjencës, autoritetet publike dhe çdo subjekt tjetër të përfshirë në menaxhimin e ngjarjes.

K R E U IX

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 48

DISPOZITA TE FUNDIT

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut ose për çështje të forcave madhore do të zgjidhen duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.97/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin", Kodit Civil, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" të ndryshuar, ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" të ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i Statutit të FSHJ-se, përpara se të regjistrohet në Gjykatën kompetente, miratohet me urdhër të Ministrit përgjegjës për Sportet.

Në rast mosmarrëveshesh brenda FSHJ-se, të cilat çojnë në paralizimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së FSHJ-se, Ministri përgjegjës për Sportin ka të drejtë të pezullojë veprimtarinë e organeve drejtuese të FSHJ-se. dhe të emërojë me mandat të përkohshëm një kryetar të FSHJ-se për të drejtuar veprimtarinë e kësaj federate dhe për të përgatitur thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme Zgjedhore.

Ky Statut hyn në fuqi me legalizimin në Gjykatën e Tiranës..

Presidenti i FSHJ

Muhamet HARIZI

Sekretar i Përgjithshëm i FSHJ

Labo ÇAPO

